



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.8

9 shkurt

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 29.1.2009	Për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian	161
Vendim i Kuvendit nr.228, datë 29.1.2009	Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive	162
Vendim i Kuvendit nr.229, datë 2.2.2009	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	165
Vendim i Kuvendit nr.230, datë 2.2.2009	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	165
Vendim i Kuvendit nr.231, datë 2.2.2009	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	166
Vendim i Kuvendit nr.232, datë 2.2.2009	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	166
Vendim i Kuvendit nr.233, datë 2.2.2009	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	167
Vendim i Kuvendit nr.234, datë 2.2.2009	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	167
Vendim i Kuvendit nr.235, datë 2.2.2009	Për zgjedhjen e kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	168

Vendim i Kuvendit nr.236, datë 2.2.2009	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese	168
Vendim i KM nr.45, datë 21.1.2009	Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike.....	169
Vendim i KM nr.46, datë 21.1.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar	169
Vendim i KM nr.53, datë 21.1.2009	Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime	171
Vendim i KM nr.55, datë 21.1.2009	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të parë, në shkollën e lartë universitare private “Kristal”, filiali Fier	173
Vendim i KM nr.56, datë 21.1.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, pranë shkollës së lartë universitare private “UFO dental”	174
Vendim i KM nr.57, datë 21.1.2009	Për hapjen e filialit të shkollës së lartë universitare private “Kristal” në qytetin e Korçës	175
Vendim i KM nr.60, datë 21.1.2009	Për realizimin shërbimit financiar të letërkredisë, në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në procesin e privatizimit të tij	176
Vendim i KM nr.61, datë 21.1.2009	Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr.558, datë 16.8.2006, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Inspektimit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Brendshme”	176
Vendim i KM nr.62, datë 21.1.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1093, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të sistemit tatimor”	178
Vendim i KM nr.63, datë 21.1.2009	Për kontratat jashtë qendrave të tregtimit	180
Vendim i KM nr.64, datë 21.1.2009	Për kontratat në largësi	181
Vendim i KM nr.65, datë 21.1.2009	Për kontratat e paketave të udhëtimit	184
Vendim i KM nr.70, datë 21.1.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Arras, të qarkut të Dibrës	189
Vendim i KM nr.71, datë 21.1.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Ujmisht, të qarkut të Kukësit	190

Vendim i KM nr.72, datë 21.1.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i mbikalimeve Lushnjë- Fier	191
Vendim i KM nr.73, datë 21.1.2009	Për licencimin e kolegjit profesional privat “Dentarium-AI”	201
Vendim i KM nr.74, datë 21.1.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, në shkollën e lartë universitare private “Universiteti Evropian i Tiranës”	201
Vendim i KM nr.90, datë 27.1.2009	Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Visokës, ndërmjet Albpetrol, sha-së dhe IEC Visoka, Inc	203

REZOLUTË
PËR INTEGRIMIN E SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Me vendosmërinë për të përmbushur objektivin madhor strategjik të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian;

Me bindjen se Komunitetet Europiane përbëjnë bërthamën e vlerave të demokracisë, lirisë, bashkëjetesës në paqe e në stabilitet të qëndrueshëm;

Në mbështetje të përpjekjeve për krijimin e një shoqërie të begatë, nëpërmjet konsolidimit të ekonomisë së tregut dhe forcimit të vlerave të shtetit të së drejtës, në dobi të qytetarëve shqiptarë;

I bindur se ky integrim do të shërbejë qenësisht si një kontribues aktiv në forcimin dhe stabilizimin e qëndrueshëm të situatës në Europën Juglindore, bashkëjetesës në harmoni dhe zhvillimit dinamik të rajonit, duke e çliruar atë përfundimisht nga kujtesat e hidhura të së kaluarës;

Nisur nga fakti që, nga pikëpamja gjeografike, historike dhe kulturore, Shqipëria, si vend europian, qëndron në ndërthurjen e rrugëve, që lidhin Europën dhe kulturën europiane me hapësirën mesdhetare;

Bazuar

Në nenin 49 të Traktatit të Bashkimit Europian, lidhur me procedurat dhe kushtet e kandidimit e më pas të anëtarësimit;

Ripërsërit gatishmërinë dhe vendosmërinë për vazhdimësinë dhe thellimin e punës tashmë të nisur për përafrimin e plotë të sistemit ligjor të Republikës së Shqipërisë me standardet dhe *l'acquis communautaire* të Bashkimit Europian, duke vënë në themel të kësaj pune bashkëpunimin më të gjerë dhe afatgjatë mes partive parlamentare të Shqipërisë;

Deklaron përkushtimin e tij për konsolidimin e vlerave të lirisë dhe të shtetit të së drejtës, garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, të diversitetit kulturor dhe ruajtjes së identitetit kombëtar të çdo vendi;

Inkurajon Qeverinë e Republikës së Shqipërisë që, në momentin e përshtatshëm, në konsultim edhe me vendet anëtare të Bashkimit Europian, të paraqesë aplikimin e Shqipërisë për të kaluar si vend kandidat në këtë organizëm dhe të raportojë për këtë në Kuvendin e Shqipërisë për ecurinë e negociatave;

Shpreson dhe mirëpret që Parlamenti Europian, vendet anëtare dhe institucionet e tjera të Bashkimit Europian të marrin në konsideratë vendosmërinë dhe konsensusin që ekziston mes të gjitha forcave politike të Republikës së Shqipërisë dhe aspiratës së popullit të saj, në lidhje me integrimin europian, ashtu sikundër ato shprehen edhe në frymën e kësaj rezolute.

29 janar 2009

VENDIM
Nr.228, datë 29.1.2009

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE
KONTROLLIT TË PASURIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË


VENDOSI:

- I. Miratohet struktura e ILDKP-së, sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
- II. Miratohet organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të ILDKP-së, sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- III. Vendimi i Kuvendit nr. 183, datë 12.5.2008, shfuqizohet.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Lidhja nr.1

**STRUKTURA
E INSPEKTORIATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**



**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS
TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/Klasa
I. Inspektor i Përgjithshëm	1	Ligji nr. 9584, neni 4
Kabineti		
Drejtor kabineti	1	II-a VKM 901(2007)
Këshilltar	1	II-b VKM 901(2007)
Sekretar i Inspektorit të Përgjithshëm	1	Ligji nr. 9584, neni 7
II. Sekretar i përgjithshëm	1	I-b VKM 901(2007)
III. Inspektorë të lartë		
Inspektorë	10	II-a + 10 000 lekë
Ndihmësinsektorë	10	II-b + 10 000 lekë
IV. Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse		
Drejtor	1	II-b VKM 901(2007)
IV/1 Sektori i Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist	2	III-b
IV/2 Sektori Juridik		
Specialist	2	III-b
V. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve të Brendshme		
Drejtor	1	II-b VKM 901(2007)
V/1 Sektori i Protokoll-Arkivit		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist	2	III-b
V/2 Sektori i Teknologjisë së Informacionit		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist	1	III-b

V/3 Sektori i Financës

Specialist financë-buxhet	1	IV-a
Specialist	1	III-b
Magaznier	1	Kl. IV VKM 477 (2007)
Shofer i titullarit	1	Kl. VI lidhja II/M VKM 477 (2007)
Shofer	1	Kl. IV lidhja II/5 VKM 477 (2007)
Receptionist	1	Kl. I VKM 477 (2007)
Pastruese	2	Kl. II VKM 477 (2007)

Gjithsej**45 punonjës****VENDIM****Nr.229, datë 2.2.2009****PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e grupimit të deputetëve të partive të shumicës parlamentare (PR),

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

- I. Zoti Klement Zguri zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE**Jozefina Topalli (Çoba)****VENDIM****Nr.230, datë 2.2.2009****PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e grupimit të deputetëve të partive të opozitës parlamentare (PSD),

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

- I. Zoti Pandeli Varfi zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE**Jozefina Topalli (Çoba)**

VENDIM
Nr.231, datë 2.2.2009

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Dëshira Subashi zgjidhet anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.232, datë 2.2.2009

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Artan Lazaj zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.233, datë 2.2.2009

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Hysen Osmanaj zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.234, datë 2.2.2009

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 14 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Vera Shtjefni zgjidhet anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.235, datë 2.2.2009

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 15 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e grupit parlamentar të partisë më të madhe të shumicës parlamentare (PD),

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Arben Ristani zgjidhet Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.236, datë 2.2.2009

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS
KUSHTETUESE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 125 të Kushtetutës dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.5991, datë 7.1.2009,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënien e pëlqimit për zotin Admir Thanza si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, deri në përfundimin e mandatit të zotit Gjergj Sauli.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.45, datë 21.1.2009

**PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK NË MËNYRË
ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen me mjete elektronike.
 2. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të nxjerrë udhëzimet përkatëse, në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.46, datë 21.1.2009

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN
PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27 e 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në “Rregullat për prokurimin publik”, që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 10.1.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja “d” e pikës 2 “Prokurimi i përqendruar dhe organi qendror blerës”, të kreut 1, “Organizimi i prokurimit publik”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Organi qendror blerës shqyrton dhe miraton specifikimet teknike, të dërguara nga autoritet kontraktore.

Nëse organi qendror blerës gjykon se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me ligjin për prokurimin publik ose se mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre.

Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën me specialistë të fushës, të institucioneve përgjegjëse, si dhe me specialistë të jashtëm, vendas ose të huaj, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet.

Nëse autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore, kanë marrë për bazë çmime të ndryshme, për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përlllogarit të dhënat sasiore, sipas fondit të vënë në dispozicion.”.

2. Shkronja “a” e pikës 1 “Kufijtë monetarë” të kreut II “Rregulla të përgjithshme të prokurimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Në përputhje me nenin 27 të ligjit për prokurimin publik, kufijtë monetarë janë:

i) Kufiri i lartë monetar:

- 1 200 000 000 lekë, për kontratat e punëve publike;
 - 200 000 000 lekë, për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.
- ii) Kufiri i ulët monetar:
- 12 000 000 lekë, për kontratat e punëve publike;
 - 8 000 000 lekë, për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.”.
3. Në kreun III “Dokumentet e tenderit” bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- A. Në fjalinë e parë të paragrafit të dytë të shkronjës “ë” të pikës 2 “Informacion i përgjithshëm”, fjalët “... e cila llogaritet si diferencë e çmimit më të lartë,...” zëvendësohen me “... e cila llogaritet si diferencë ndërmjet çmimit të kontratës dhe çmimit më të lartë,..”.
- B. Në pikën 3 “Informacion i veçantë” bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
- a) Në nënndarjen e dytë të nënndarjes “i” “Për kapacitetet financiare dhe ekonomike” të shkronjës “a” “Kontratat për punë”, fjalët “...dhe ose raportet e menaxhimit financiar, të certifikuara nga një subjekt i jashtëm, i licencuar, auditimi;”, shfuqizohen.
- b) Në nënndarjen “ii” “Për kapacitetet teknike dhe profesionale”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i) në nënndarjen e parë, fjalët “licencat profesionale” zëvendësohen me “licenca profesionale e shoqërisë”;
 - ii) nënndarja e dytë shfuqizohet;
 - iii) në nënndarjen e tretë, fjalët “...dhe për numrin e stafit drejtues...”, shfuqizohen.
- c) Në nënndarjen e dytë të nënndarjes “i” “Për kapacitetet financiare dhe ekonomike” të shkronjës “b”, “Kontratat e mallrave”, fjalët “..., dhe ose raportet e menaxhimit financiar, të certifikuara nga një subjekt i jashtëm, i licencuar auditimi;”, shfuqizohen.
- ç) Në nënndarjen e dytë të nënndarjes “i” “Për kapacitetet financiare dhe ekonomike” të shkronjës “c” “Kontratat e shërbimeve”, fjalët “...dhe ose raportet e menaxhimit financiar, të certifikuara nga një subjekt i jashtëm, i licencuar auditimi;”, shfuqizohen.
4. Në fund të paragrafit të parë të shkronjës “a” të pikës 5 “Procedura me negociim, pa shpallje të njoftimit” të kreut IV “Llojet dhe përzgjedhja e procedurave”, pas fjalëve “...asnjë ofertë...” shtohen “...apo kërkesë e përshtatshme...”.
5. Në kreun V “Zhvillimi i procedurave”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- a) Shkronja “d” e pikës 1 “Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim”, shfuqizohet.
- b) Në pikën 2 “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, bëhen këto ndryshime:
- i) Në fund të shkronjës “b” shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje: “Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, botimi i dokumenteve të tenderit do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.
 - ii) Në fjalinë e parë të shkronjës “ç” fjalët “... i emëruar në përputhje me shkronjën “d”, të pikës 1, të këtij kreu,...” zëvendësohen me “... i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor...”.
- c) Në fund të shkronjës “d” të pikës 3 “Dorëzimi i ofertave”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:
- “Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.
- ç) Pas nënndarjes “i” të pikës 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:
- “Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, procedura e hapjes dhe e vlerësimit të ofertave do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.
6. Në nënndarjen “Lista e shkurtër e kandidatëve”, të shkronjës “ç”, të pikës 3, “Shërbimet e konsulencës”, të kreut VI, “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozim, prokurimi me vlera të vogla, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- a) Fjalja “Lista e shkurtër përfshin të pakën 3 kandidatë” zëvendësohet me “Lista e shkurtër përfshin të paktën 2 kandidatë”.
 - b) Fjalja e fundit e kësaj nënndarjeje shfuqizohet.

7. Në fund të shkronjës “c” të pikës 2 “Bashkimi i operatorëve” të kreut VII “Kushtet e përgjithshme për zbatim”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i parë, i përcaktuar në paragrafin e shtatë të shkronjës “a” “Kontratat për punë” të pikës 3 “Informacione të veçanta” të kreut III, “Dokumentet e tenderit”, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.53, datë 21.1.2009

PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA E SHËRBIME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 2 të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Brendshme, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve të poshtëshënuara:

- i) Blerje automjetesh;
- ii) Blerje karburanti;
- iii) Blerje materialesh kancelarie;
- iv) Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash;
- v) Abonim në shtyp;
- vi) Blerje materialesh të ndryshme për pastrim;
- vii) Blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera, përbërëse të tyre;
- viii) Blerje këpucësh;
- ix) Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike;
- x) Blerje tonerash;
- xi) Blerje pajisjesh elektronike dhe telekomunikacioni;
- xii) Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi;
- xiii) Sigurim automjetesh;
- xiv) Shërbim interneti dhe e-mail-i;
- xv) Shërbimi për ruajtje me roje private;
- xvi) Shërbim pastrimi;
- xvii) Shërbim lyerje ndërtesash.

2. Ministria e Brendshme të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo institucion, për secilin nga mallrat dhe shërbimet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 31 janar, të dërgojnë në Ministrinë e Brendshme, si organi qendror blerës, të dhënat, teknike e sasiore, dhe fondin përkatës, për çdo prokurim.

4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të mallrave e të shërbimeve, sipas artikujve të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi;

b) të bashkërendojë punën me autoritetet kontraktore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për prokurimet publike, që do të zhvillojë si organ qendror blerës;

c) të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore me ligjin dhe standardet në fuqi;

ç) të shqyrtojë dhe miratojë specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore.

Nëse gjykohet se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me ligjin për prokurimet publike ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, organi qendror blerës kryen rishikimin e specifikimeve teknike, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse, ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;

d) të unifikojë specifikimet teknike, për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse, ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra.

dh) të bashkërendojë punën për testimin e tregut, për përllogaritjet e të dhënave sasiore për mallrat, që do të prokurohen, para publikimit të tenderit. Në këto raste organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;

e) të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të fituesit;

ë) të bashkëpunojë me Agjencinë e Prokurimit Publik, për mbarëvajtjen e procedurave të prokurimit.

5. Organi qendror blerës, në raste përjashtimore, mund të zhvillojë procedurë prokurimi edhe kur kërkohet nga një autoritet a një grup autoritetesh kontraktore, që nuk janë përcaktuar në këtë vendim, apo edhe për mallra a shërbime, që nuk janë përcaktuar në këtë vendim.

6. Organi qendror blerës, në rast se autoritetet kontraktore kanë kërkesa, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit, verifikon arsyet e vonesës dhe vendos për shpalljen ose jo të procedurës së re të prokurimit për këto kërkesa.

7. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të udhëzojë autoritetet kontraktuese për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi për zbatimin e vendimit.

9. Vendimi nr.53, datë 16.1.2008 i Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, për disa mallra dhe shërbime, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.55, datë 21.1.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË PARË, NË SHKOLLËN E LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “KRISTAL”, FILIALI FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare private “Kristal”, filiali Fier, të dy programeve të studimit, të ciklit të parë. Programet e studimit, që do të ofrohen në formën e studimeve me kohë të plotë, do të jenë:

- a) Drejtësi;
- b) Infermieri.

2. Këto programe studimi do të jenë të njëjta me programet e studimit, që shkolla e lartë universitare private “Kristal”, ofron, përkatësisht, në Fakultetin e Drejtësisë dhe në Fakultetin e infermierisë, në selinë qendrore të saj, në Tiranë. Ato do të realizohen, përkatësisht, me 180 kredite dhe kohëzgjatja e tyre normale do të jetë tri vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP), në fushat përkatëse të arsimimit të kryer.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Kristal”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Shkolla e lartë universitare private “Kristal” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Kristal”, filiali Fier, duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.56, datë 21.1.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “UFO DENTAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “UFO dental”, Tiranë, për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Gazetari, me profil:
 - i) Marrëdhënie me publikun dhe marketing;
 - ii) Drejtim dhe menaxhim i mediave;
 - iii) Gazetari ndërkombëtare.
- b) Marrëdhënie ndërkombëtare, me profil:
 - i) Politika e jashtme dhe diplomacia;
 - ii) Integrim evropian;
 - iii) Studime ballkanike, studime për sigurinë.
- c) Administrim publik, me profil:
 - i) Pushtet ekzekutiv;
 - ii) Qeverisje vendore;
 - iii) Hapësira publike evropiane;
 - iv) Politika dhe menaxhimi shëndetësor
- ç) Menaxhim bankar:
- d) Administrim biznesi.

2. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit, të ciklit të dytë, do të jetë 2 vite akademike, me plotësimin, së paku, të 120 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND), në fushën e arsimimit të kryer.

3. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “UFO dental”, me seli në Tiranë, për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të parë”, në:

- a) e drejta tregtare.

4. Programi i studimit “Master i nivelit të parë” është pjesë e studimeve të ciklit të dytë, me, së paku, plotësimin e 60 krediteve. Në mbarim të programit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP) në fushën e arsimimit dhe të trajnimit të kryer.

5. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “UFO dental”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

6. Shkolla e lartë universitare private “UFO dental”, do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

7. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Shkolla e lartë universitare private “UFO dental”, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.57, datë 21.1.2009

PËR HAPJEN E FILIALIT TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE
“KRISTAL” NË QYTETIN E KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në qytetin e Korçës, të filialit të Fakultetit të Shkencave Politike dhe Sociale, të Fakultetit të Drejtësisë dhe atij të Infermierisë, si pjesë përbërëse të shkollës së lartë universitare, private “Kristal”, me seli në Tiranë, në programet e studimit, të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në fushat:

- a) Drejtësi;
- b) Infermieri;
- c) Administrim Publik;
- ç) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- d) Shkenca komunikimi.

2. Këto programe studimi do të jenë të njëjta me programet e studimit, që shkolla e lartë universitare private “Kristal”, ofron, përkatësisht, në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Sociale, në Fakultetin e Drejtësisë dhe në atë të infermierisë, në selinë qendrore të saj, në Tiranë. Ato do të realizohen, përkatësisht, me 180 kredite dhe kohëzgjatja e tyre normale do të jetë tri vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP), në fushat e arsimimit të kryer.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Kristal”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Shkolla e lartë universitare private “Kristal”, do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Filiali i shkollës së lartë universitare private “Kristal” në Korçë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.60, datë 21.1.2009

**PËR REALIZIMIN SHËRBIMIT FINANCIAR TË LETËRKREDISË, NË FAVOR TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES, NË PROCESIN E PRIVATIZIMIT
TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbim financiar, në kuptim të këtij vendimi, është letërkredia, e nxjerrë nga banka, agjente për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, si pjesë e transaksionit financiar të marrëveshjes së garancisë pjesore të riskut, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

2. Procedura e realizimit të këtij shërbimi financiar do të bëhet në baza konkurruese, sipas vlerësimit të kryer nga Ministria e Financave dhe të pranuar nga Banka Botërore.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për përgatitjen e listës së bankave, që do të marrin pjesë në këtë konkurrim, dhe të kërkesës për propozim, për realizimin e këtij procesi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.61, datë 21.1.2009

**PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË VENDIMIN NR.558, DATË 16.8.2006, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
SHTETIT, TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE INSPEKTIMIT TË
PËRGJITHSHËM, NË MINISTRINË E BRENDSHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.558, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për pagat e punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe të Inspektimit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Brendshme”.

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe të Inspektimit të Përgjithshëm, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi (kolonat 4 e 5 të lidhjes nr.1) jepet sipas funksioneve, të përcaktuara në këtë lidhje.”.

ç) Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. “Specialistët, përgjegjësit e sektorit apo drejtorët e shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe të Inspektimit të Përgjithshëm, të cilët punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së këtyre drejtorive dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh mbi pagën mujore, të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.

d) Pikat 5 e 6 numërtohen, përkatësisht, 7 e 8.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2009 do të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Brendshme, në buxhetin e vitit 2009.

3. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij zbatimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE INSPEKTIMIT TË PËRGJITHSHËM

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesat për natyrë të veçantë pune e shërbimi	
			Në funksion të shërbimeve mbështetëse të SHKB	Në funksione të drejtorisë së SHKB
1	2	3	4	5
Bazë	Agjent	33 000	2000	6500
	Agjent i I-rë	34 500	2000	6500
	Asistent	36 500	2000	6500
	Asistent i I-rë	37 500	2000	6500
	Kryeasistent	39 000	2000	6500
I mesëm	Nëninspektor	46 500	2000	6500
	Inspektor	48 500	2000	6500
	Kryeinspektor	55 500	2000	6500
I lartë	Nënkomisar	68 000	2000	7500
	Komisar	82 000	2000	7500
	Kryekomisar	94 000		20 000

VENDIM
Nr.62, datë 21.1.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.1093, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT TATIMOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1093, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin emërtim e numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Në pikën 2, fjalët në kllapa “ ... (kolona 2)... ” zëvendësohen me “ ... (kolona 3)... ”.
 3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“ 3. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 5) e lidhjes nr.1 jepet 2% pas çdo viti pune, por jo më shumë se 25 % dhe llogaritet mbi pagën e grupit. Për emërtesën “Nëninspektor” shtesa për vjetërsi në punë jepet 1% pas çdo viti pune dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit. ”.
 4. Në pikën 4, fjalët në kllapa “ ... (kolona 4)... ” zëvendësohen me “ ... (kolona 6)... ”.
 5. Në pikën 5, fjalët në kllapa “ ... (kolona 5)... ” zëvendësohen me “ ... (kolona 7)... ”.
 6. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 e 5/2, me këtë përmbajtje:
“ 5/1. Shtesa për kushte pune është sipas kolonës 8 të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5/2. Numri i punonjësve, për pozicionin “Nëninspektor”, në drejtoritë/sectorët e investigimit, nuk do të jetë më shumë se 30% e numrit të përgjithshëm të punonjësve të drejtorisë/sectorit. ”.
 7. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“6. Nëpunësit, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi, pagat e të cilëve janë përcaktuar në lidhjen nr.1, nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, me akte të tjera të Këshillit të Ministrave.”.
 8. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“ 7. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve e të drejtorive rajonale, që kategorizohen në kategoritë D.2 e D.3, përcaktohen sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës, në institucionet buxhetore. ”.
 9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e miratuara për sistemin e tatimeve, në buxhetin e vitit 2009.
 10. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË TATIMEVE

				PAGA MUJORE			
			EMËRTIMI	PAGA INDIVIDUALE		SHTESA E POZICIONIT	
Kategoria e vendit të punës	Kategoria e pagës	Paga e Grupit (PG)		Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
1	2	3	4	5	6	7	8
	II-a	11 000	Drejtor i Përgjithshëm	2%		103 500	20 000
	II-b	11 000	Zv/drejtor i përgjithshëm	2%		86 500	15 000
A	III-a	11 000	Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme. Drejtor i Drejtorisë rajonale.	2%		68 500	15 000
B	III-a/1	11 000	Përgjegjës/shef sektori në Drejtorinë e Përgjithshme. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale.	2%		58 300	14 000
C.1	III-b	11 000	Përgjegjës/shef sektori/ zyre në drejtoritë rajonale. Inspektor i parë. Inspektor i auditit të brendshëm. Përgjegjës sektori në drejtoritë mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme	2%		51 500	12 000
	III-b	11 000	Përgjegjës zyre në Taks Forcë	2%		51 500	17 000
C.2	IV-a	11 000	Inspektor i dytë. Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme.	2%		39 000	12 000

	IV-b	11 000	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme. Specialist në drejtoritë rajonale.	2%		29 000	10 000
C.3	IV-c	11 000	Specialist.	2%		21 500	5000
D.1	IV-b	11 000	Sekretar në Drejtorinë e Përgjithshme.	2%		29 000	5000
	IV-c	11 000	Sekretar në drejtoritë rajonale	2%		21 500	5000
			Nëninspektor.	1%		25 000	10 000

VENDIM
Nr.63, datë 21.1.2009

PËR KONTRATAT JASHTË QENDRAVE TË TREGTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontratat jashtë qendrave të tregtimit, mbështetur në nenet 34 e 35 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, rregullohen sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë vendim.

2. Dispozitat e pjesës VI të kreut I të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, do të zbatohen edhe për kontratat:

a) e furnizimit me mallra ose shërbime, përveç atyre, për të cilat konsumatori ka kërkuar vizitën e tregtarit, me kusht që, kur e ka kërkuar vizitën nuk dinte ose, në mënyrë të arsyeshme, nuk mund të dinte, se furnizimi me këto mallra a shërbime të tjera ishte pjesë e veprimtarisë, tregtare apo profesionale, të tregtarit;

b) për të cilat është bërë një ofertë nga konsumatori, sipas kushteve të ngjashme me ato të parashikuara në pikën 1 të nenit 34 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, pavarësisht nëse konsumatori është i lidhur ose jo nga oferta e tij, përpara pranimit të ofertës nga tregtari.

3. Njoftimi me shkrim, i dhënë nga tregtari për konsumatorin, për të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, sipas pikës 3 të nenit 35 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, përfshin emrin dhe adresën e personit, ndaj të cilit mund të ushtrohet kjo e drejtë. Njoftimi ka të shënuar datën dhe të dhëna të veçanta, që mundësojnë identifikimin e kontratës. Konsumatorit i jepet njoftim:

a) me një dokument të veçantë, që përmban vetëm këtë njoftim, dhe të ndarë nga kushtet e përgjithshme të kontratës, nëse ka të tilla.

b) përpara lidhjes së kontratës ose në kohën e ofertës, së bërë nga konsumatori.

4. Njoftimi i konsumatorit për heqjen dorë nga kontrata bëhet me shkrim dhe ka të shënuar datën. Njoftimi dërgohet në adresën e treguar nga tregtari, përpara mbarimit të afatit, prej 14 ditësh kalendarike.

5. Dëshmia e dërgimit të njoftimit, sipas pikës 4 të këtij vendimi, është provë e mjaftueshme, për të vërtetuar jo vetëm se është bërë njoftimi i duhur, por edhe datën, kur ai është bërë.

6. Nëse konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë, sipas pikës 1 të nenit 35 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, malli, i cili është objekt i kontratës, i kthehet tregtarit brenda 5 ditëve, duke filluar nga data në të cilën konsumatori ka njoftuar tregtarin për vendimin e tij, për heqjen dorë. Çdo shumë e paguar nga konsumatori për mallrat ose shërbimet kompensohet nga tregtari brenda 15 ditëve, duke filluar nga e njëjta datë.

7. Kur çmimi i mallrave ose i shërbimeve është plotësisht a pjesërisht i mbuluar nga një kredi, të dhënë nga tregtari ose nga një person tjetër, dhe ka një lidhje të ngushtë tregtare ndërmjet kredidhënësit dhe tregtarit, marrëveshja e kredisë anulohet, pa shpenzim dhe penalizim për konsumatorin, nëse konsumatori ushtron të drejtën e tij, të heqjes dorë.

8. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.64, datë 21.1.2009

PËR KONTRATAT NË LARGËSI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 61 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontratat në largësi, bazuar në nenet 36, 37, 38 e 39 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, rregullohen sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë vendim.

2. Për qëllime të këtij vendimi:

a) “Mjete të komunikimit në largësi”, përveç mjeteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 36 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, janë, gjithashtu:

i) radioja;

ii) videofoni (telefon me ekran);

iii) videotexti (mikrokompjuter dhe ekran televizori), me tastierë ose ekran të prekshëm;

iv) kompjuteri;

v) interneti;

vi) çdo mjet, i cili mund të përdoret për lidhjen e një kontrate të shitjes në largësi.

b) “Operator i mjeteve të komunikimit” është çdo person, fizik a juridik, publik a privat, i cili, në tregtinë, biznesin ose profesionin e vet bën të disponueshëm për tregtarët një a më shumë mjete të komunikimit në largësi.

c) “Shërbim financiar” është çdo shërbim i lidhur me veprimtarinë e institucioneve të kreditit, të shoqërive të sigurimit dhe atyre investuese, të tilla si:

i) Pranimi i depozitave ose mjeteve të tjera të pagesës;

ii) Huadhënia, përfshirë kreditë konsumatore, huatë hipotekore;

iii) Kontratat e qirave financiare;

iv) Transferimi i parave, dhënia dhe menaxhimi i lehtësive financiare;

v) Këmbimi valuator;

vi) Sigurimi dhe mbulimi i detyrimit;

vii) Pranimi, shpërndarja dhe/ose përmbushja e urdhrave e i dispozitave të shërbimeve përkatëse, sipas produkteve financiare: instrumentet e tregut të parasë, transferimi i letrave me vlerë, operacionet financiare/futures, opsionet dhe kurset e këmbimit valuator, si dhe lehtësitë e përqindjeve të interesit;

viii) Menaxhimi i portofolit të investimit dhe provigjionimi i investimeve të pranuar, për instrumentet e nëndarjes “viii”;

ix) Mbajtja dhe menaxhimi i letrave me vlerë;

x) Provigjionimi i depozitave të arkave të kursimit;

xi) Sigurimin e jetës;

xii) Çdo sigurim tjetër, me përjashtim të atij të përmendur në nëndarjen “xi”;

xiii) Sigurimi i fondit të investimeve;

xiv) Sigurimi shëndetësor;

xv) Skemat e pensioneve personale.

3. Mjetet e komunikimit në largësi, që e lejojnë tregtarin për të pasur një komunikim individual me konsumatorin, përveç atyre të përcaktuara në nenin 39 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, do të përdoren nga tregtari, me kusht që konsumatori të mos ketë shprehur qartë mospëlqimin e tij për përdorimin e tyre.

4. Tregtari, përpara lidhjes së kontratës, jep, në një kohë të arsyeshme, të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 37 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, si edhe këto të dhëna:

a) Adresën e tregtarit, në rast se kontrata kërkon pagesë paraprake;

b) Kostot postare dhe të transportit, për dorëzimin e mallit, si dhe të gjitha taksat, që nuk përfshihen në çmimin e mallit apo të shërbimit;

c) Koston e përdorimit të mjeteve të komunikimit në largësi, kur llogaritet në mënyra të ndryshme nga norma/mënyra bazë;

ç) Periudhën për të cilën çmimi i caktuar mbetet i vlefshëm;

d) Kohëzgjatjen minimale të kontratës, në rastin e kontratave për furnizim, të përhershëm ose periodik, të mallrave apo shërbimeve;

dh) Masat për përmbushjen e kontratës.

5. Informacioni i përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, duhet të jepet në mënyrë të qartë e të kuptueshme, me çdo rrugë të përshtatshme të mjeteve të komunikimit në largësi, duke shprehur karakterin tregtar të ofertës, në përputhje me parimet e mirëbesimit të transaksioneve tregtare, praktikave të mira tregtare dhe legjislacionit në fuqi, për mbrojtjen e personave, të cilët nuk janë në gjendje të japin miratimin e tyre.

6. Në rastin e bisedave telefonike, tregtari, që në fillim paraqet veten të konsumatori, si dhe i njofton atij qëllimin tregtar të telefonatës.

7. Tregtari i konfirmon konsumatorit, me shkrim ose me ndonjë mjet tjetër, të qëndrueshëm, informacionin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 37 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, si dhe në pikën 4 të këtij vendimi, në një kohë të arsyeshme gjatë zbatimit të kontratës dhe jo më vonë se çasti i dorëzimit, nëse mallrat nuk iu dorëzohen palëve të treta, të lidhura me to.

Kërkesa e përcaktuar në këtë pikë nuk zbatohet vetëm në rast se, përpara lidhjes së kontratës, konsumatori i është dhënë ky informacion, me shkrim ose me ndonjë mjet tjetër, të qëndrueshëm, të disponueshëm dhe të pranueshëm për të.

8. Informacioni që i jepet konsumatorit sipas pikës 7 të këtij vendimi, përmban:

a) Emrin e tregtarit dhe adresën e biznesit të tij, ku konsumatori mund të paraqesë çdo ankesë;

b) Të drejtën e konsumatorit për të hequr dorë nga kontrata, si dhe kushtet e procedurat për ushtrimin e kësaj së drejte;

c) Kushtet për anulimin e kontratës, kur kjo ka një afat/kohëzgjatje të pacaktuar ose ka afat më të gjatë se një vit;

ç) Të dhëna për shërbimet pas shitjes dhe garancinë.

9. Dispozitat e pikave 7 e 8, shkronjat “c” e “ç”, nuk zbatohen ndaj shërbimeve, të cilat janë kryer nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit në largësi, kur ato janë siguruar vetëm në një rast dhe janë faturuar nga operatori i mjeteve të komunikimit në largësi.

10. Dispozitat e pikës 3 të nenit 37 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, nuk do të zbatohen për kontratat e mëposhtme:

a) Për kushtet e shërbimeve, kryerja e të cilave ka filluar me një marrëveshje të shpejtë të konsumatorit dhe ka përfunduar përpara afatit prej 14 ditësh kalendarike, të përcaktuara në pikën 3 të nenit 37 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”;

b) Për furnizimin e mallrave ose të shërbimeve, çmimi të cilave varet nga luhatjet në tregjet financiare, që nuk mund të kontrollohen nga furnizuesi;

c) Për furnizimin e mallrave sipas specifikimeve të konsumatorit apo personalizimit të qartë, ose të cilat, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të kthehen apo kanë mundësi të prishen a t’u përfundojë shpejt afati;

ç) Për furnizimin e regjistrimeve audio e video ose të programeve kompjuterike, të cilat janë hapur nga konsumatori;

d) Për furnizimin e gazetave, të revistave dhe botimeve të tjera periodike;

dh) Për lojërat e fatit dhe shërbimet e lotarisë.

11. Në rastet kur tregtari nuk arrin të përmbushë detyrimet e veta, për dhënie informacioni, të përcaktuara në pikën 7 të këtij vendimi, ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata brenda tri muajve nga data e marrjes së mallrave ose nga data e lidhjes së kontratës, për ofrimin e shërbimit.

12. Kur informacioni, sipas pikës 7 të këtij vendimi, i është dhënë konsumatorit brenda një periudhe trimujore, sipas pikës 11 të këtij vendimi, afati prej 14 ditësh kalendarike, i përcaktuar në pikën 3 të nenit 37 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, do të fillojë në çastin e marrjes së informacionit.

13. Kur konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë, të përcaktuar në pikën 3 të nenit 37 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, tregtari është i detyruar të kthejë shumën e paguar nga konsumatori brenda 30 ditëve, duke filluar nga data në të cilën konsumatori ka ushtruar të drejtën e heqjes dorë.

14. Konsumatori mban në mirëbesim mallin e marrë nga tregtari, në cilësinë dhe sigurinë e duhur, gjatë afatit të përcaktuar në pikën 3 të nenit 37 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”.

15. Në rast anulimi të marrëveshjes së kredisë, sipas përcaktimit në pikën 4 të nenit 37 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, konsumatori nuk i paguan tregtarit ose palës kredituese asnjë shpenzim a kompensim.

16. Çdo kusht i kontratës, për të cilin është rënë dakord ndërmjet palëve, që kundërshton dispozitat e pikës 4 të nenit 37 të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, është i pavlefshëm dhe shfuqizohet.

17. Kur konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontrata në largësi për shërbimet financiare, ai paguan tregtarin, brenda 14 ditëve kalendarike, vetëm nëse:

a) shumën e përgjigjet çmimit të shërbimit financiar, të dhënë efektivisht nga shitësi, përpara ushtrimit të së drejtës së heqjes dorë, pavarësisht nga çasti i heqjes dorë;

b) kostoja e shërbimit financiar, e dhënë efektivisht nga tregtari, varet nga koha në të cilën është ushtruar e drejta e heqjes dorë, një shumë që i jep mundësi konsumatorit të llogarisë çmimin, që duhet paguar mbi një normë bazë, për periudhën ndërmjet datës në të cilën është lidhur kontrata dhe datës në të cilën konsumatori ushtron të drejtën e tij të heqjes dorë.

Në të dyja rastet e përshkruara në shkronjat “a” e “b” të kësaj pike, shumën për t’u paguar nuk duhet të jetë e tillë, që të interpretohet si penalizim.

18. Tregtari vë në dijeni konsumatorin, në mënyrë të përshtatshme, përpara lidhjes së kontratës, për vlerën, në bazë të së cilës është llogaritur çmimi, që do të paguhet nga konsumatori, sipas shkronjës “b” të pikës 17 të këtij vendimi.

19. Nëse tregtari nuk provon se ai e ka vënë në dijeni konsumatorin për çmimin e shërbimit financiar, konsumatori nuk është i detyruar të paguajë shërbimet e dhëna nga tregtari, në rast se ai ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontrata në largësi për këto shërbime.

20. Nëse një tregtar nuk arrin të përmbushë, nga ana e tij, një kontratë, mbi bazën që mallrat ose shërbimet e porositura janë të padisponueshme, ai vë në dijeni konsumatorin dhe i kompenson çdo shumë të paguar, brenda 30 ditëve, duke filluar nga data në të cilën tregtari duhej të kishte përmbushur detyrimet kontraktuale.

21. Tregtari mund t’i sigurojë konsumatorit mallra dhe shërbime me cilësi dhe çmim ekuivalent, me kusht që kjo mundësi të ishte marrë parasysh qartësisht përpara lidhjes së kontratës

ose të ishte përfshirë në kontratë. Në këtë rast, tregtari vë në dijeni konsumatorin për këtë mundësi, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

22. Kostoja e kthimit të mallrave, në vijim të ushtrimit të së drejtës të heqjes dorë, për rastet e përmendura në pikën 21 të këtij vendimi, i ngarkohet tregtarit dhe konsumatori duhet të njoftohet për këtë.

23. Barra e provës për detyrimet e tregtarit për ta vënë në dijeni konsumatorin, sipas pikave 4, 7, 18, 20 e 21, të këtij vendimi, për miratimin e nga ana e këtij të fundit për lidhjen e kontratës dhe, kur është e arsyeshme, për përmbushjen e saj, bien mbi tregtarin.

24. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.65, datë 21.1.2009

PËR KONTRATAT E PAKETAVE TË UDHËTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 61 të ligjit nr 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontratat e paketave të udhëtimit, në bazë të neneve 46 e 47 të ligjit 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, rregullohen sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë vendim.

2. Për qëllime të këtij vendimi:

a) “Organizator” është tregtari, i cili organizon paketat e udhëtimit dhe i shet ose i ofron ato për shitje, drejtpërdrejt a nëpërmjet një shitësi me pakicë;

b) “Shitës me pakicë” (më poshtë shitësi) është tregtari, i cili shet ose ofron për shitje paketa udhëtimesh, të përgatitura nga organizatori;

c) “Konsumator” është personi, i cili merr ose bie dakord të marrë paketën e udhëtimit (kontraktuesi kryesor), ose çdo person, në emër të të cilit, kontraktuesi kryesor bie dakord të blejë paketën, apo çdo person, tek i cili kontraktuesi kryesor a çdo njëri prej përfituesve të tjerë transferon paketën;

ç) “Kontratë e paketës së udhëtimit” është marrëveshja e lidhur ndërmjet konsumatorit me organizuesin dhe/ose shitësin.

3. Kur organizatori ose shitësi i siguron konsumatorit një material të parapërgatitur, me shkrim (broshurë, fletëpalosje etj.), në të duhet të tregohen, në mënyrë të lexueshme, të kuptueshme dhe të saktë, përveç informacionit, të përcaktuar në nenin 47 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, edhe informacioni i mëposhtëm:

a) Data e fillimit dhe e mbarimit të udhëtimit;

b) Hollësitë kryesore të akomodimit e të miratimit të tij dhe klasifikimin turistik, sipas rregullave të vendit mikpritës;

c) Afati i fundit për informimin e konsumatorit, në rast anulimi të paketës së udhëtimit, nëse për zhvillimin e paketës së këtij udhëtimi kërkohet një numër minimal pjesëmarrësish;

ç) Të dhëna të përgjithshme për formalitetet shëndetësore, të kërkuara për udhëtimin dhe qëndrimin;

d) Emri i shoqërisë së sigurimit, me të cilën organizatori ka lidhur një kontratë sigurimi, sipas pikës 40 të këtij vendimi.

4. Organizatori ose shitësi i paketës së udhëtimit është përgjegjës për informacionin e dhënë sipas pikës 3 të këtij vendimi, dhe nuk mund ta ndryshojë atë, përveç rasteve kur:

a) ndryshimet në informacionin që përmban broshura i janë komunikuar qartësisht konsumatorit përpara lidhjes së kontratës, dhe kjo mundësi ka qenë saktësisht e parashikuar dhe e deklaruar në broshurë;

b) ndryshimet janë bërë më vonë, në vijim të një marrëveshjeje ndërmjet palëve të kontratës së paketës së udhëtimit.

5. Përpara lidhjes së kontratës së paketës së udhëtimit, organizatori dhe/ose shitësi duhet të njoftojnë konsumatorin, me shkrim, për të gjitha kushtet e kontratës, si dhe t'i japin atij një kopje të këtyre kushteve.

6. Dispozita e pikës 5 të këtij vendimi nuk zbatohet për lidhjen e kontratës ose rezervimin në çastin e fundit.

7. Organizatori dhe/ose shitësi, me anën e kontratës së paketës së udhëtimit, angazhohet t'i sigurojë konsumatorit një paketë udhëtimi kundrejt pagesës së një çmimi të caktuar.

8. Kontrata e paketës së udhëtimit lidhet në formë të shkruar dhe konsumatorit i jepet një kopje e saj.

9. Kontrata e paketës së udhëtimit përmban elementet e mëposhtme:

a) Datën dhe vendin e lidhjes së kontratës;

b) Emrin dhe adresën e organizatorit dhe/ose të shitësit;

c) Mënyrat, karakteristikat dhe kategorinë e transportit, që do të përdoret, datat, oraret dhe pikat e nisjes e të kthimit;

ç) Vendndodhjen e akomodimit, kur paketa e udhëtimit e përfshin, kategorinë turistike ose shkallën e komoditetit, veçoritë kryesore dhe përputhshmërinë e tij me rregullat e vendit pritës e planin e vakteve të ngrënies;

d) Llojin dhe nivelin e furnizimit me ushqim (catering) e vendet e argëtimit, numrin dhe tipin e vakteve të ngrënies, të përfshira në paketën e udhëtimit;

dh) Afatin e fundit për informimin e konsumatorit, në rast anulimi të paketës së udhëtimit, nëse për zhvillimin e kësaj pakete kërkohet një numër minimal pjesëmarrësish;

e) Itinerarin e paketës së udhëtimit;

ë) Vizitat, ekskursionet ose shërbimet e tjera, të cilat janë të përfshira në çmimin e përgjithshëm, e për të cilat është rënë dakord për t'u përfshirë në paketën e udhëtimit;

f) Kërkesat specifike, të cilat konsumatori ia ka bërë të njohura organizatorit ose shitësit, kur ka bërë rezervimin përfundimtar, dhe për të cilat palët kanë rënë dakord;

g) Çmimin e plotë/përfundimtar të paketës së udhëtimit, në lekë, për të gjitha shërbimet e përfshira në kontratë;

gj) Kalendarin dhe mënyrën e pagesës;

h) Të dhënat për mundësinë e rishikimit të çmimit, procedurën dhe mënyrën e rilogaritjes së tij, në rastet e parashikuara në pikën 16 të këtij vendimi, si dhe të dhënat për çdo taksë të pritshme ose pagesë, që mund të ngarkohen për shërbime të caktuara (tarifat në porte për hipje dhe zbritje në anije, tarifat në aeroporte, taksat turistike), kur kosto të tilla nuk janë përfshirë në paketën e udhëtimit;

i) Afatin e fundit, për të cilin konsumatorit i është dhënë e drejta e heqjes dorë nga kontrata, pa qenë përgjegjës për shpenzime dhe kompensim;

j) Nivelin e dëmshpërblimit, që konsumatori detyrohet t'i paguajë organizatorit dhe/ose shitësit, në rast të heqjes dorë të konsumatorit nga kontrata, pas mbarimit të afatit, sipas shkronjës "i" të kësaj pike;

k) Afatin, kur konsumatori njofton organizuesin dhe/ose shitësin, përpara nisjes, për qëllimin e tij, për të transferuar rezervimin përfundimtar te një person i tretë, si dhe afatin e fundit, për të cilin konsumatori duhet të njoftojë organizatorin e paketës së udhëtimit ose shitësin për faktin se ai e ka transferuar paketën e vet te një palë e tretë;

l) Numrin minimal të pjesëmarrësve, të kërkuar për të zhvilluar paketën e udhëtimit, si dhe afatin e fundit për njoftimin e konsumatorëve, në rast se ky numër nuk arrihet dhe paketa e udhëtimit mund të anulohet;

m) Detyrimin për të njoftuar konsumatorin për të drejtat e tij, të parashikuara në pikat 19 e 22 të këtij vendimi;

n) Afatet, brenda të cilave konsumatori mund të bëjë ankesë për mospërbushjen ose përmbushjen e papërshtatshme të kontratës së paketës së udhëtimit;

nj) Emrin dhe adresën e siguruesit, me të cilin organizatori ka lidhur një kontratë sigurimi, në bazë të pikës 40 të këtij vendimi.

10. Organizatorit dhe/ose shitësit të paketës së udhëtimit, për mospërbushjen e kontratës së kësaj pakete, nuk i lejohet t'i referohet mungesës së njëërës prej elementeve të kontratës, përcaktuar në pikën 9 të këtij vendimi.

11. Kontrata për organizimin e paketës së udhëtimit nuk duhet të përmbajë kushte të padrejta kontraktuale, sipas nenit 27 të ligjit "Për mbrojtjen e konsumatorit".

12. Organizatori dhe/ose shitësi i paketës së udhëtimit i sigurojnë konsumatorit, me shkrim ose në një formë tjetër të përshtatshme, përpara lidhjes së kontratës, një informacion të përgjithshëm për kërkesat e zbatueshme për vizat dhe pasaportat, veçanërisht, për afatet kohore për pajisjen me to, si dhe informacion për formalitetet shëndetësore, për udhëtimin dhe qëndrimin.

13. Organizatori dhe/ose shitësi i paketës së udhëtimit i sigurojnë konsumatorit, me shkrim ose në një formë tjetër të përshtatshme, në një kohë të arsyeshme, përpara fillimit të udhëtimit, por jo më vonë se 7 ditë pune përpara fillimit të udhëtimit, informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin e shoqërisë, adresën dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit të tij vendor në vendin që do të vizitohet dhe, në mungesë të një përfaqësuesi, të dhëna për të kontaktuar agjencitë vendore, të vendit që do të vizitohet, të cilat mund t'i japin asistencë konsumatorit, nëse ndodhet në vështirësi. Në rast mungese të agjencive të tilla vendore, konsumatorit duhet t'i jepet një numër telefoni emergjence ose çdo informacion tjetër, që i mundëson atij të kontaktojë organizuesin dhe/ose shitësin;

b) Oraret dhe vendet e ndalesave të ndërmjetme dhe të pikave lidhëse të udhëtimit, si dhe hollësi për vendet, që do të zihen nga udhëtari, si kabina ose shtrati në anije, ndarjet e fjetjes në tren;

c) Për sigurimin, në përmbushje të kontratës së paketës së udhëtimit, në bazë të pikës 40 të këtij vendimi;

ç) Për mundësimin e kontaktimit të drejtpërdrejtë me të miturin ose me personin përgjegjës për të miturin, në vendin e qëndrimit, në rast të udhëtimit ose qëndrimit jashtë Shqipërisë të të miturve;

d) Për mundësinë e marrjes, jo të detyrueshme, të një police sigurimi, për të mbuluar kostot e anulimit nga konsumatori ose kostot e asistencës, përfshirë riatdhesimin, në rast aksidenti ose sëmundjeje.

14. Kur periudha ndërmjet lidhjes së kontratës së udhëtimit dhe datës së fillimit të udhëtimit është më e vogël se 7 ditë pune, informacioni i përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi, duhet të sigurohet në çastin e lidhjes së kontratës.

15. Informacioni i përcaktuar në pikat 3, 9, 12 e 13 të këtij vendimi, jepet në gjuhën shqipe.

16. Çmimi i dhënë në kontratën e paketës së udhëtimit nuk është objekt rishikimi, vetëm në rast se kontrata parashikon qartë mundësinë e një ndryshimi të këtij çmimi, si dhe përcakton, me saktësi, mënyrën e llogaritjes së çmimit të rishikuar. Në këtë rast ndryshimet lejohen vetëm për:

a) kostot e transportit përfshirë koston e lëndës djegëse;

b) shuma për t'u paguar, taksa ose tarifa, që vihen në ngarkim, për përdorimin e disa shërbimeve të caktuara, sipas kontratës (tarifat në aeroporte, porte dhe/ose tarifa të tjera);

c) kursin e këmbimit, të përdorur në kontratën e paketës së udhëtimit, në periudhën ndërmjet lidhjes së kontratës dhe datës së nisjes.

17. Gjatë 20 ditëve përpara datës së përcaktuar të nisjes, çmimi i deklaruar në kontratën e paketës së udhëtimit nuk duhet të rritet.

18. Rritja e çmimit të paketës së udhëtimit duhet të argumentohet ekonomikisht dhe të jetë në proporcion me ndryshimet, që pësojnë kostot.

19. Nëse organizatori vëren se përpara nisjes ai është i detyruar të kryejë ndryshime të rëndësishme në ndonjërin nga kushtet thelbësore të kontratës së paketës së udhëtimit, organizatori ose shitësi duhet ta njoftojë, sa më shpejt të jetë e mundur, konsumatorin, për t'i mundësuar atij marrjen e vendimeve të duhura dhe, në veçanti:

a) pranimin e një shtojce në kontratë, duke specifikuar ndryshimet e bëra dhe ndikimin e tyre në çmim,

b) heqjen dorë nga kontrata, pa penalizim.

20. Çdo ndryshim i çmimit në një vlerë më të madhe se 5% është ndryshim thelbësor i kontratës.

21. Konsumatori informon organizatorin ose shitësin e paketës së udhëtimit për vendimin e tij, sipas pikës 19 të këtij vendimi, brenda tri ditëve nga data e marrjes së njoftimit, por jo më vonë se dita e nisjes.

22. Nëse konsumatori heq dorë nga kontrata e paketës së udhëtimit, sipas shkronjës "b", të pikës 19, të këtij vendimi, ose nëse, për çfarëdo shkak, me përjashtim të fajit/gabimit të konsumatorit, apo nëse organizatori anulon paketën përpara datës së nisjes, për të cilën është rënë dakord, konsumatorit i lind e drejta të zgjedhë njërën nga mundësitë e mëposhtme:

a) Ofrimin e një paketë zëvendësuese, ekuivalente ose të një cilësie më të lartë, kur organizatori a shitësi janë në gjendje t'ia ofrojnë;

b) Ofrimin e një pakete udhëtimi zëvendësuese, me një cilësi më të ulët. Në një rast të tillë organizatori ose shitësi duhet t'i kompensojnë konsumatorit diferencën e çmimit ndërmjet paketës së udhëtimit të anuluar dhe asaj të ofruar;

c) Kthimin e të gjithë shumës së paguar nga konsumatori, sipas kontratës së paketës së udhëtimit, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të heqjes dorë, sipas pikës 21 të këtij vendimi.

23. Në rastet e përcaktuara në pikën 22 të këtij vendimi, konsumatorit i lind e drejta të kërkojë kompensim nga organizatori ose shitësi, për të gjitha dëmet, materiale dhe jomateriale, të shkaktuara nga mospërbushja ose përbushja e papërshtatshme e kontratës së paketës së udhëtimit, me përjashtim kur:

a) anulimi bëhet për shkak të numrit të personave të regjistruar për paketën e udhëtimit, që është më i vogël se numri minimal i kërkuar dhe për këtë, konsumatori ka qenë informuar siç duhet nga organizatori dhe/ose shitësi për anulimin brenda afatit të përcaktuar në kontratën e paketës së udhëtimit;

b) anulimi i udhëtimit është rrjedhojë e një force madhore.

24. Tejkalimi i kapacitetit të rezervimeve përfundimtare për udhëtimin nuk është forcë madhore.

25. Konsumatori mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kontratës së paketës së udhëtimit te një palë e tretë, e cila plotëson të gjitha kushtet e paketës. Në një rast të tillë, konsumatori njofton organizatorin ose shitësin, përpara nisjes, për qëllimet e transferimit të rezervimit të tij te një palë e tretë, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

26. Konsumatori, i cili transferon të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kontratës së paketës së udhëtimit dhe personi, te i cili transferohet paketa e udhëtimit, janë përgjegjës, solidarë dhe veçmas, tek organizatori ose shitësi i kontratës për pagesën e një shumë të caktuar nga çmimi i përgjithshëm dhe për çdo kosto shtesë, që rrjedh nga ky transferim.

27. Konsumatori njofton për çdo mospërbushje të kontratës së paketës turistike, të cilën ai e dallon në vend, furnizuesin e shërbimit në fjalë dhe organizatorin dhe/ose shitësin, me shkrim ose në një formë tjetër të përshtatshme, me mundësinë më të parë. Ky detyrim duhet të përcaktohet, qartë dhe saktë, në kontratë. Njoftimi bëhet me shkrim ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme, përfshirë faksin, e-mailin ose mjete të tjera teknike, të cilat sigurojnë mundësinë për riprodhimin e saj.

28. Furnizuesi i shërbimit në fjalë dhe organizatori dhe/ose shitësi i paketës së udhëtimit apo përfaqësuesi i tyre vendor duhet të marrin menjëherë masat e nevojshme, për të kënaqur konsumatorin, brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe të gjejnë zgjidhjen e përshtatshme.

29. Organizatori dhe/ose shitësi i paketës së udhëtimit janë përgjegjës ndaj konsumatorit, për përbushjen e duhur të detyrimeve, që rrjedhin nga kontrata e paketës së udhëtimit, pavarësisht nëse këto detyrime janë për t'u përbushur nga organizatori dhe/ose shitësi apo nga një tjetër furnizues i shërbimeve.

30. Organizatori dhe/ose shitësi i paketës së udhëtimit mund të paraqesë pretendim kundrejt nënkontraktorëve të tij, në rast mospërmbushje të detyrimeve të tyre, që rrjedhin nga kontrata e paketës së udhëtimit, për furnizimin e shërbimeve.

31. Organizatori dhe/ose shitësi i paketës së udhëtimit janë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar nga mospërmbushja ose përmbushja e papërshtatshme e kontratës së paketës së udhëtimit, vetëm nëse kjo mospërmbushje ose përmbushje e papërshtatshme e kontratës vjen si shkak i:

a) konsumatorit;

b) veprimeve, të një pale të tretë, që nuk ka lidhje me ofrimin e shërbimeve të kontraktuara, të cilat janë të paparashikuara ose të pashmangshme;

c) një rrethane të një force madhore ose një ngjarjeje, të cilën organizatori dhe/ose nënkontraktorët e tij, me gjithë kujdesin e duhur, nuk mund ta parashikonin a të parandalonin.

32. Për rastet, që u referohen shkronjave “b” e “c”, të pikës 31, të këtij vendimi, organizatori dhe/ose shitësi i paketës së udhëtimit duhet t’i japin ndihmën e menjëhershme konsumatorit në vështirësi.

33. Kontrata e paketës së udhëtimit mund të parashikojë një kufi maksimal të përgjegjësisë së organizatorit dhe/ose shitësit për dëmet e shkaktuara konsumatorit, nga mospërmbushja ose përmbushja e papërshtatshme e kontratës së paketës së udhëtimit. Në këtë rast, kufiri maksimal i përgjegjësisë së organizatorit dhe/ose shitësit, për të cilën është rënë dakord nga palët e kontratës, nuk duhet të kalojë trefishin e çmimit të paketës së udhëtimit.

34. Kur përgjegjësia e nënkontraktorëve të organizatorit dhe/ose shitësit për dëmet e shkaktuara nga mospërmbushja ose përmbushja e papërshtatshme e shërbimeve, sipas kontratës së paketës së udhëtimit kufizohet nga marrëveshje ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, kontrata e paketës së udhëtimit mund të parashikojë një kufizim të përgjegjësisë së organizatorit dhe/ose shitësit, në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje.

35. Dispozitat e pikave 33 e 34, të këtij vendimi, nuk zbatohen për dëme, që rrjedhin nga mospërmbushja ose përmbushja e papërshtatshme e shërbimeve, të përfshira në paketën e udhëtimit për dëmtime vetjake.

36. Pa përjashtuar dispozitat e pikave 33 e 34 të këtij vendimi, kontrata e paketës së udhëtimit nuk duhet të përmbajë asnjë kusht kontraktual, që çliron organizatorin dhe/ose shitësin nga përgjegjësia e përcaktuar në pikat 29 e 31 të këtij vendimi.

37. Në rast se pas nisjes, një pjesë e rëndësishme e shërbimeve të kontraktuara nuk sigurohet, ose organizatori kupton, se nuk mund të sigurojë një pjesë të rëndësishme të shërbimeve, që duhet të ofrohen, organizatori merr masa alternative, të përshtatshme, pa kosto shtesë për konsumatorin, për vazhdimin e paketës së udhëtimit, dhe kompenson konsumatorin për diferencën, ndërmjet shërbimeve të parashikuara dhe atyre të siguruara realisht.

38. Në rast se organizatori i paketës nuk merr masat e duhura, në përputhje me pikën 37, të këtij vendimi, për vazhdimin e paketës së udhëtimit, konsumatori mund të kërkojë kompensim për shpenzimet shtesë, që ka kryer.

39. Kur është e pamundur marrja e masave të duhura, të parashikuara në pikën 37, të këtij vendimi, ose kur këto masa, për shkaqe të arsyeshme, nuk janë të pranueshme nga konsumatori, organizatori duhet:

a) t’i sigurojë atij, pa kosto shtesë, me një transport ekuivalent, kthimin në vendin e nisjes ose në një pikë tjetër kthimi, për të cilin konsumatori bie dakord;

b) të dëmshpërblejë konsumatorin për dëmet e shkaktuara.

40. Organizatori i paketës së udhëtimit duhet të ketë një kontratë sigurimi të detyrueshme, që mbulon përgjegjësinë e tij për dëmet e shkaktuara, si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve, përfshirë rastet e paaftësisë paguese dhe falimentimit.

Kontrata e sigurimit lidhet me një shoqëri sigurimi, në përputhje me dispozitat e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për sigurimin dhe risigurimin, dhe mbulon:

a) kthimin e parave të paguara nga konsumatori, sipas kontratës së paketës së udhëtimit;

b) kompensimin e diferencës, nëse gjatë paketës së udhëtimit përmbushen vetëm një pjesë e shërbimeve të kontraktuara;

c) shpenzimet për kthimin e konsumatorit në vendin e nisjes.

41. Kur organizatori ose shitësi i paketës së udhëtimit nuk është në gjendje t'i sigurojë konsumatorit kontratën e vlefshme të sigurimit, sipas pikës 40 të këtij vendimi, konsumatorit i lind e drejta të heqë dorë nga kontrata e paketës së udhëtimit, pa asnjë shpenzim a penalizim.

42. Heqja dorë e konsumatorit nga kontrata e paketës së udhëtimit, sipas pikës 41, të mësipërme, bëhet me shkrim tek organizatori ose shitësi, përpara nisjes.

43. Kontrata e sigurimit, sipas pikës 40 të këtij vendimi, lidhet për një afat 1-vjeçar, dhe jo më vonë se 30 ditë përpara mbarimit të këtij afati, kontrata rinovohet ose lidhet një kontratë e re.

